



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 982 Prot.

Tiranë, më 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 149, Datë 23 . 06 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 263 Regj., datë 27.12.2024, të z. P. L, përfaqësuar me prokurë të posaçme³, nga znj. P. L, kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), subjekti ankues, z. P. L, përfaqësuar nga motra e tij, znj. P. L, informon Komisionerin lidhur me problematikën e tij, për të cilën shprehet se:

“Gjatë viteve 2000, unë bashkë me familjarët e mi ndërtuam objektin nr. 10/772, në rrugën “J. Pashko”, Laprakë. Për të gjithë ne, në atë urinë e skamjes, duke derdhur këtu të gjithë energjitë

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar prokurës së posaçme me nr. 1780 Rep., nr. 616/1 Kol, datë 03.09.2016.

⁴ Si të persekutuar politikë, me statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë - bazuar në Vërtetimin për dhënie statusi, me nr. 622 prot., datë 04.07.2024, të Institutit të Integritetit të Ish-të Përndjekurve Politikë.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

e jetës tonë, për shkak se mbetëm me kredi, u detyruam të shesim nëntë hyrje të papërfunduara nën çmimin e kostos.

U përpoqa shumë dhe çdo vit bëra kërkesa pranë institucioneve për legalizimin e objektit, por nuk më përgjigjeshin. I kërkoja ndihmë dhe Prefekturës, e cila u interesua, por përsëri vazhduan të talleshin me mua dhe me ndonjë shkresë formale.

Kërkesës time për projektin e unazës, ASHK, në muajin qershor 2000, u përgjigj se objekti im nuk do të prekej nga projekti ekzistues. Në muajin mars 2021⁵, DV ASHK Tirana Veri, kërkesës time të radhës iu përgjigj me njoftimin se objekti im nuk legalizohet për shkak të unazës (projekt i cili u ndryshua shpejt pa zë, për qëllime të liga, pas 9 muajve). Mbas këtij njoftimi të rëndë, iu drejtova Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila me vendimin nr. 1214, datë 19.04.2022, e vlerësoi të reegullt dhe të plotë detyrimin e vetëdeklaruesit për legalizimin e objektit Pllum Lera dhe për moslegalizimin e objektit Gjykata, fajësoi ASHK-në.

Në muajin shkurt 2022, paraqita ankesën time për diskriminim nga ASHK-ja, si të persekutuar politikë, tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, çështje e cila u pushua. Mendoj se Gjykata, e diktuar nga ligji nr. 20/2020 urdhëroi ASHK-në, të dali me vendim për legalizimin e objektit tim. Këtë vendim ASHK, e shpërfilli për ato dy vite, megjithatë, kërkesat e shumta që bëra, pranë ASHK-së deri në Ministrinë e Drejtësisë, me qëllimin djallëzor për të më humbur kohë, për t'më hequr mundësinë e përsëritjes së kërkesës para Gjykatës, për legalizimin e objektit tim. Në 2023, i kërkuam ndihmë Përmbartimit Shtetëror për zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative dhe menjëherë, ASHK, e skualifikoi objektin tim, me anët të vendimeve për moslegalizim. Në muajin shkurt 2024, IKMT më dërgoi urdhër për prishjen e katit përdhe të objektit (mbi të cilin qëndronin 5 kate të lidhura me të, me hekur e beton të bardhë brenda). Pastaj IKMT, më dërgoi gjobë 7000000 për ndërtim të paligjshëm (të bërë 20 vjet më parë).

Objektin e shëmbi IKMT, me lëndë plasëse, me datë 01.03.2024, pa vendim për prishjen e tij, pa procesverbal ekzekutimi. Gjashtë firmëtarët vërtetuan vetëm shëmbjen e objektit përdhe, dhe jo të ndërtesës bashkë me katin përdhe në të njëjtën sekond të datës 01.03.2024. IKMT, shëmbi edhe pesë katet e tjera, mbi të parin, duke hedhur në atë të gjithë mundin e jetës tonë, dhe duke nxjerrë të pastrehë të gjithë banorët.”

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Konsatatimin e diskriminimit nga ana e DV ASHK Tirana Veri”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

⁵ Për shkak të shkrimit jo të qartë të numrit/muajit, ankuesi i referohet si mars (numri 3), por nga përmbajtja e shkresës dhe akteve të tjera evidentohet se bëhet fjalë për muajin shtator, pra numri që i korrespondon muajit i referohet 9-ës.

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Bazuar në nenin 32/1/b të Ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës me nr. 71 prot., datë 09.01.2025, ka kërkuar nga DV ASHK Tirana Veri, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - *“Informacion në lidhje me problematikën e pretendimet e paraqitura nga subjekti ankues.*
 - *Informacion lidhur me procedurat e ndjekuara mbi rastin e ankuesit, si dhe të evidentohen arsyet e mos kryerjes së legalizimit të objektit ë tij nga viti 2006, deri në vitin 2023;*
 - *Kopje e korrespondencës zyrtare të institucionit, me ankuesin përgjatë periudhës 2006-2023;*
 - *Kopje e praktikës së legalizimit, që administron institucioni mbi ndërtesën objekt legalizimi;*
 - *Informacion mbi banorë të tjerë, të kësaj zone që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë depozituar kërkesë për legalizim pranë institucionit tuaj, në të njëjtën periudhë kohore (Në vitin 2006) me ankuesin;*
 - *Informacion mbi faktin se sa prej këtyre objekteve janë legalizuar. Të dërgohen kopje të akteve përkatëse të legalizimit;*
 - *Informacion mbi banorë të tjerë, të kësaj zone që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim pranë institucionit tuaj në periudhën kohore 2006-2023 dhe objektet e tyre janë legalizuar; Bashkëlidhur të dërgohen kopje të akteve të legalizimit.*

- Informacion mbi banorë të tjerë, të së njëjtës zonë me ankuesin, që kanë ndërtuar pa leje ndërtimi, kanë depozituar kërkesë për legalizim në periudhën kohore 2006-2023 dhe objektet e tyre janë legalizuar. Bashkëlidhur depozitohen kopje të akteve të legalizimit;
- Informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të z. P. L. para vitit 2021;
- Planet e veprimit për vitet 2019-2023, të DV ASHK Tirana Veri;
- Kopje të projektit të segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë.
- Informacion mbi bllokun kadastral, ku ndodhej objekti informal i deklaruar nga ankuesi. Të përcaktohet numri i legalizimeve në këtë bllok kadastral nga viti 2006-2023, duke i kategorizuar për secilin vit, si dhe numri i objekteve informale ende të palegalizuara në këtë bllok kadastral; (ku të evdientohen në mënyrë të qartë objektet që janë prekur nga zbatimi i këtij projekti, të evdidentohet objekti i ankuesit dhe i personave/objekteve të cituara prej tij, si të legalizuara, duke specifikuar për secilin objekt respektivisht nëse është prishur aktualisht nga zbatimi i këtij projekti, pas legalizimit apo jo).
- Informacion nëse subjekti ankues e ka kundërshtuar administrativisht apo gjyqësisht vendimin e moslegalizimit të objektit/ndërtesës së tij nga ana e DVASHK Tirane Veri. Nëse po, kopje të akteve respektive (kërkesë-padi apo vendime gjykate, nesë ka të tilla).
- Informacion nëse subjekti ankues ka ngritur pretendime për diskriminim kundrejt DVASHK Tirana Veri, lidhur me vendimin e moslegalizimit të objektit/ndërtesës së tij (administrativisht apo gjyqësisht). Nëse po, kopje të akteve respektive.

2. Me shkresën nr. 205/2 prot., datë 07.02.2025, DV ASHK Tirana Veri, ka depozituar pranë KMD-së parashtime, si dhe një pjesë të dokumentacionit të kërkuar. DV ASHK Tirana Veri, ndër të tjera, sqaron se:

“Subjekti ka aplikuar me nr. 4023 prot., datë 15.09.2006, pranë Njësisë Administrative nr. 11, për godinën “6 kate”, me funksion “banim”.

Referuar dokumentacionit të administruar në praktikë, rezulton se administrohen disa deklarata noteriale, depozituar pranë nesh me nr. 44 B, datë 17.05.2018, ku si objekt kanë shitblerjen e disa apartamenteve të ndodhura në ndërtesën 6 katëshe.

DV ASHK Tirana Veri vijoi procedurat e legalizimit konform ligjit 20/2020 “Për përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e aktit të legalizimit...”, specifikisht pikës 8, ku citohet se:

Procedura e legalizimit kryhet për subjektin që, sipas rastit, është aplikuesi për legalizim ose/dhe personi të cilit i janë njohur të drejta mbi ndërtimin pa leje, nëpërmjet:

- a) veprimeve juridiko-civile me akt notarial, për kalimin e së drejtës së legalizimit, trashëgimisë ose deklaratës noteriale së aplikuesit, për njohjen e të drejtave të të tretit mbi ndërtimin.

Dokumentacioni sipas kësaj shkronje dorëzohet nga subjektet përpara përfundimit të procedurave administrative të miratimit të aktit të legalizimit; ose
b) vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar shkresës me nr. 15189/1 prot., datë 10.09.2021, nga ASHK, për dijeni ARRSH, në kuadër të shpronësimit të pasurive që preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Bulevardi i Ri – Shkozë”, si dhe pas verifikimit të gjendjes së objektit ka rezultuar se ndërtimi informal i vetëdeklaruar nga z. L prekej nga ky projekt.

Në lidhje me situatën në të cilën mendohet se është bërë në formën e një diskriminimi, sqarojmë se Drejtoria e jonë udhëhiqet nga disa parime kryesore, ndër të cilat dhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe parimi i sigursë juridike.

Shqyrtimi i praktikave të legalizimit për objektet informale kryhet nga Drejtoritë vendore, në përputhje me organizimin e punës, sipas njësive strukturore “bllok kadastral”, si dhe duke iu referuar një plani pune, pasi secila praktikë ka problematika të ndryshme specifike.

Me Vendimin nr. 1214, datë 19.04.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur detyrimi i palës së paditur DV ASHK Tirana Veri, të dalë më vendim në lidhje me kërkesën për legalizim të objektit informal vetëdeklaruar me nr. 4023 prot., datë 15.09.2006, të palës paditëse z. P. L.

Me Vendimet nr. 5425, nr. 5426, nr. 5427, datë 21.11.2023, DV ASHK Tirana Veri, ka vendosur “Moslegalizimin e ndërtimit pa leje”, vetëdeklaruar me nr. 4023 prot., datë 19.09.2006, nga P. L. L.

Me nr. 6329 Akti, datë 22.04.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka kërkuar paraqitjen pranë kësaj Gjykate, me datë 10.06.2024, në çështjen me palë: paditës P. L, P. L dhe të paditur ASHK, etj, me objektin “Paligjshmëri....”, (gjyqi aktiv).”

3. Në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe procesit të drejtë administrativ, parashtrimet dhe dokumentacioni i depozituar pranë Komisionerit nga ana e DV ASHK Tirana Veri, i është përcjellë për njohje edhe subjektit ankues.
4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 403 prot., datë 03.03.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

5. Seanca u zhvillua në datë 18.03.2025, me praninë e znj. P. L, përfaqësuese e subjektit ankues, dhe znj. K. T, me detyrë Specialiste Juriste pranë DV ASHK Tirana Veri, përfaqësuese e tij, sipas Autorizimit me nr. 2336/1 prot., datë 18.03.2025, të titullarit të këtij Institucioni.

Gjatë seancës dëgjimore, palët u qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën me nr. 403/2 prot., datë 26.03.2025, Komisioneri kërkoi nga ASHK dhe DV ASHK Tirana Veri, informacionin si më poshtë vijon:

- *“ Informacion dhe kopje të dokumentacionit (respektivisht kopje e kërkesës për aplikim dhe të vendimit për legalizim të objektit, për secilin subjekt) për pasuritë, si më poshtë citohen:*
- *Për pasurinë me nr. 10/41, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit S. S;*
- *Për pasurinë me nr. 10/821, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit I. S;*
- *Për pasurinë me nr. 10/366, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit Xh. C;*
- *Për pasurinë me nr. 10/767-ND, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit A. K;*
- *Për pasurinë me nr. 10/77, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit A. I;*
- *Për pasurinë me nr. 10/284, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit K. T;*
- *Për pasurinë me nr. 10/72, në zonën kadastrale 8310;*
- *Për pasurinë me nr. 10/272, në zonën kadastrale 8310;*
- *Për pasurinë me nr. 10/854, në zonën kadastrale 8310;*
- *Për pasurinë me nr. 10/772, në zonën kadastrale 8310.*
- *Informacion mbi arsyen e mos legalizimit të ndërtimit informal të z. P. L, para vitit 2021;*
- *Planet e veprimit të DV ASHK Tirana Veri për vitet 2019-2023;*
- *Kopje të projektit të miratuar, të segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri, Shkozë.*
- *Informacion dhe kopje të aktit kur është protokolluar pranë DV ASHK Tirana Veri, projekti sipërcituar.”*

7. Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 5098/1 prot., datë 10.04.2025, ASHK-ja i drejtohet DV ASHK Tirana Veri (për dijeni KMD-së), duke cituar ndër të tjera, se:

“...duke ju tërhequr vëmendjen mbi vonesat e konstatuara, në zbatim të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë...”, si dhe akteve të miratuara në referim të tyre, kërkojmë marrjen e masave të menjëhershme, për trajtimin e rastit dhe vënien në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar prej tyre, brenda 7 ditëve nga administrimi i kësaj shkrese...”

8. Pavarësisht sa më sipër, DV ASHK Tirana Veri, nuk dërgoi asnjë informacion apo dokument të kërkuar nga KMD, lidhur me kërkesat e paraqitura nëpërmjet shkresës me nr. 403/2 prot., datë 26.03.2025, të Komisionerit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e DV ASHK Tirana Veri.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1, të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e DV ASHK Tirana Veri dhe më konkretisht në lidhje me legalizimin e banesës së tij.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Pala paditëse është vendosur në Tiranë dhe në një truall të lirë ndodhur në rrugën “Vangjel Noti”, ka ndërtuar një ndërtim pa leje.

Me qëllim legalizimin e këtij objekti, në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ankuesi ka paraqitur vetëdeklarim për legalizimin, pasqyruar në dosjen e legalizimit me nr. 4023, datë 15.09.2006. Rezulton e provuar se, një pjesë e objektit ndërtim pa leje, ndërtuar nga ankuesi, u është shitur për banim disa qytetarëve, të cilët që të gjithë kanë nënshkruar deklaratat noteriale përkatëse, me qëllim plotësimin e dosjes së legalizimit.

Referuar akteve të dosjes, rezulton e provuar se, pala ankuese ka bërë të gjithë përpjekjet e mundshme ligjore për t'u legalizuar objekti i tij. Ai ka ndjekur rregullisht procedurën për legalizimin e objektit dhe, nga korrespondenca shkresore mes tij dhe institucioneve të ndryshme, në një kronologji kohore, rezulton se:

- Nëpërmjet shkresës së datës 10.03.2009, ALUIZNI e ka informuar atë se do të shqyrtojë dokumentat tekniko-ligjore, etj;
- Nëpërmjet shkresë datë 23.06.2014, është njoftuar gjithashtu se, po ndiqen procedurat tekniko-ligjore të legalizimit;
- Nëpërmjet shkresës me nr. 817/1 prot., datë 17.06.2019 është njoftuar se dosja e tij po trajtohet në hartografi;
- Në kthim përgjigjen me nr. 1017/2 prot., datë 27.06.2019, të ASHK-së, lidhur me ankesën drejtuar Prefektes së Tiranës, evidentohet përsëri se, objekti është në fazë studimi dhe pas plotësimit të materialit tekniko-ligjor do të vijohet me procedurat e kualifikimit për rezultatin e të cilave do të njoftoheshin nga ana e DV ASHK Tirana Veri;
- Nëpërmjet shkresat me nr. 245/1 prot., dhe me nr. 245/2 prot., datë 17.02.2020, Prefektja e Tiranës kërkon nga DV ASHK Tirana Veri dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)

që t'i japë të dhëna mbi kalimin e gjurmës së projektit të unazës në zonën ku është ndërtuar objekti i ankuesit. (kërkesë kjo që vjen edhe për faktin se ankuesit ARRSH-ja nuk i ka kthyer përgjigje, lidhur me të njëjtën kërkesë).

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1512/1 prot., datë 02.06.2020, të ARRSH-së, (në kthim përgjigjen drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë - për dijeni dhe z. L) deklarohet se, “ARRSH-ja nuk disponon asnjë projekt konkret të zbatimit të infrastrukturës rrugore. Avancimi i projektit të Unazës së Madhe nga sheshi “Shqiponja” drejt krahut verilindor është në procedurë planifikimi.”

(Nga aktet shkresore të palës ankuese, drejtuar institucioneve sipërcituar (DV ASHK Tirana Veri, ASHK, ARRSH, etj) evidentohet se, deri më datë 29.09.2021⁶, ankuesit nuk i është kthyer asnjë përgjigje e qartë dhe shteruese në lidhje me kërkesat që ai kishte paraqitur në vijimësi).

- Nëpërmjet shkresës me nr. 9332/1 prot., datë 20.09.2021, DV ASHK Tirana Veri i ka komunikuar ankuesit se nga ana tyre nuk mund të vijohet me legalizimin e objektit, pasi preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri – Shkozë”.
- Ndodhur në këto kushte, pala ankuese ka kërkuar gjyqësisht, nëpërmjet kërkesë-padisë së paraqitur me datë 29.12.2021 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë: *“Detyrimin e DV ASHK Tirana Veri të bëjë legalizimin e objektit, paraqitur për legalizim me nr. 4023 prot., datë 15.09.2006, mbasi pala e paditur megjithë kërkimet e herë pas herë nuk ka vepruar”.*
- Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1214, datë 19.04.2022, ka disponuar, ndër të tjera: *“Detyrimin e palës së paditur ASHK Tirana Veri, të dalë me vendim në lidhje me kërkesën për legalizimin e objektit informal me nr. 4023 prot., datë 15.09.2006, të palës paditëse P. L.”*
- Me datë 02.06.2022, ankuesi ka kërkuar nga ASHK-ja zbatimin e vendimit të Gjykatës, kërkesë të cilën ankuesi, në kushte kur nuk po veprime nga ana e këtij Institucioni, e ka ngritur edhe nëpërmjet Zyrës Përmbartimore, me anë të shkresës me nr. 14353 prot., datë 16.11.2023.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 11286 prot., datë 22.11.2023, DV ASHK Tirana Veri, ka njoftuar ankuesin mbi vendimet e moslegalizimit të objektit të tij, ndërtim pa leje⁷, me arsyetimin e ndërtimit të segmentit rrugor “Unaza e Madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Tiranë-Shkozë”.
- Më datë 11.01.2024, ankuesi është njoftuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) për lirimin e objektit, njoftim të cilin ai e ka kundërshtuar gjyqësisht.
- Nëpërmjet vendimit të datës 02.02.2024, Gjykata ka disponuar me *refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, pasi nga IKMT, nuk ka një vendim për “Prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm”.*
- Me datë 03.02.2024, IKMT ka lënë në oborrin e banesës së z. L, kopje të Vendimit nr. 06, datë 19.01.2024 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” dhe Vendimit “Për dënim me gjobë”, me përshkrimin “P. L jo prezent”.

⁶Datë kur ankuesi ka marrë dijeni për shkresën, nëpërmjet shërbimit postar.

⁷ Respektivisht Vendimet me nr. 5416, 5417, 5418, 5419, 5420, 5421, 5422, 5423, 5424, 5425, 5426, 5427, datë 21.11.2023, të DV ASHK Tirana Veri.

- Ankuesi sa më sipër, vendimet respektive i ka kundërshtuar gjyqësisht, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet kërkesë-padisë me nr. regj. Them. 6732, datë 06.02.2024, duke kërkuar: *“Konstatimin e paligjshmërisë së vendimit të IKMT-së për “Prishjen e objektit të kundërligjshëm”, dhe shfuqizimin e Vendimit për dënimin me gjobë”*.
- Gjykata, me vendimin nr. 3604, datë 16.10.2024, ka disponuar me:
 1. *“Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së z. P. L.*
 2. *Shfuqizimin e aktit administrativ “Për dënimin me gjobë”.*
 3. *Rrëzimin e kërkesë-padisë për pjesën tjetër të objektit.*
 -”
- Subjekti ankues është ende në procese gjyqësore lidhur me pretendimin e tij për paligjshmërinë e shembjes së objektit dhe marrjen e dëmshpërblimit përkatës.
- **Sa i takon veprimeve të kryera nga DV ASHK Tirana Veri, në kuadër të procedurës së ndjekur për legalizimin e banesës së subjektit ankues.**

Nga këqyrja dhe analizimi sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Autoriteti Rrugor Shqiptar, me shkresën nr. 996/2, datë 09.04.2024, i është drejtuar Av. E. K, përfaqësuese ligjore e subjektit ankues, nëpërmjet të cilës e ka informuar se: *“Pranë ARRSH-së, ka pasur një projekt për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës, i cili përputhej me planin rregullues të Bashkisë Tiranë. Ky projekt nuk është miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit.*

Më pas, me ndryshimin e planit rregullues të Bashkisë Tiranë, ky projekt është ndryshuar për t’u përshtatur me këtë plan. Projekti final është miratuar në Këshillin Teknik të ARRSH-së dhe Këshillin Kombëtar të Territorit, me vendimin nr. 4, datë 13.07.2021 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi “Shqiponja – Bulevardi i Ri”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”.

Pas 15 viteve kërkesa të vazhdueshme, deri në datën 20.09.2021, pala ankuese nuk ka pasur asnjë dijeni në lidhje me fazën aktuale të legalizimit të objektit të tij. Dhe me sa rezulton nga përmbajtja e shkresave, as vetë ASHK-ja, të paktën deri në këtë datë nuk ka pasur asnjë dijeni se objekti i kërkuarit, z. P. L do të prekej nga ky projekt për segmentin rrugor të vazhimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi “Shqiponja” - Bulevardi i Ri, apo se kishte një projekt të tillë.

Ankuesi pretendon se zvarritja e procedurave për legalizimin e ndërtesës së tij ka zgjatur mbi 15 vjet, gjë që ka bërë që ai të përfundimisht të mos fitojë pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur (pasi tashmë nuk ekziston më, është shembur më datë 19.01.2024).

Ankuesi pretendon gjithashtu, se, moslegalizimi i banesës i ka humbur atij dhe të drejtën të përfitojë dëmshpërblimin përkatës, dhe se ky trajtim që i është bërë atij nga ana e DV ASHK Tirana Veri është krejtësisht i padrejtë, i pabarabartë e i pafavorshëm, krahasuar edhe me

trajtimin që ky insitucion u ka bërë komshinjeve të tij kufitarë, ndodhur në të njëjtat kushte me të, duke cituar se:

“Prona ime me nr. 10/772 nuk është legalizuar, ndërsa të gjitha objektet e tjera përreth tij (pa përjashtim) janë legalizuar: edhe ato me madhësi pothuajse të njëjtë me objektin tim (objekti me nr. 10/284, i z. K. T), edhe në nivel barake (si pasuritë me nr. 10/821, 10/854, etj), apo objekte pa kurrfarë korrektese ndërtimore, si pasuria me nr. 10/336, ku murin e avllisë së përbashkët me mua e ka bërë mur shtëpie.... Të gjithë komshinjtë përreth kanë marrë për objektet e tyre që preken nga projekti i Unazës, dëmshpërblime të kënaqshme, ndërsa unë jo, duke u ndjerë personi më i fyer, diskriminuar e dëmtuar mbi tokë”.

Nga këqyrja e akteve dhe dinamika e ngjarjeve rezulton se, pala ankuese është vendosur në Tiranë, në një truall të lirë të ndodhur në rrugën “Vangjel Noti”, ku ka ndërtuar një ndërtim pa leje.

Nga aktet në dosje, rezulton se, një pjesë të këtij objekti, ndërtim pa leje, të ndërtuar prej tij, pala ankuese, e ka shitur dhe në to banonin personat që e kanë blerë, të cilët dhe kanë nënshkruar deklaratat noteriale përkatëse, me qëllim plotësimin e dosjes së legalizimit.

Për legalizimin e këtij objekti, ankuesi, në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ka paraqitur vetëdeklarim për legalizim, me datë 15.09.2006, pasqyruar në dosjen me nr. 4023, datë 15.09.2006.

Për sa më sipër, rezulton se vetëdeklarimi i ankuesit është depozituar pranë ish-ALUIZN-it, Drejtorisë Rajonale Tiranë, i cili ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën u miratua ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-ALUIZN-it.

Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhrit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, “Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të objekteve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZN-it.

Në referencë të nenit 5, të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Në nenet 18, 20 dhe 21, të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet si më poshtë citohet:

“18. Kriteret për legalizim

1. ASHK-ja kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e moscenimit të:

- a) veprave kryesore të infrastrukturës publike;
 - b) akseve rrugore kombëtare;
 - c) territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike;
 - ç) integritetit të pasurive kulturore materiale, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;
 - d) territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) vijës bregdetare, në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit.
2. Ndërtimet pa leje që cenojnë kriteret e mësipërme nuk legalizohen. Ato regjistrohen në bazën e të dhënave vetëm për efekt njohjeje të vlerës së investimit të ndërtimit, sipas parashikimeve në nenin 33 të këtij ligji.
3. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin moslegalizim vetëm për sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi.
4. Procedurat, rregullat dhe dokumentacioni për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20, Dokumentacioni për legalizim

1. Dokumentacioni për legalizimin e ndërtimit pa leje përfshin:

- a) genplanin e ndërtimit;
 - b) planimetrinë e çdo kati të ndërtimit dhe sipërfaqet në m²;
 - c) aktekspertizat nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate, si dhe për shtesën në ndërtim të regjistruar dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.
2. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, në dokumentacionin e legalizimit, përveç sa parashikohen në pikën 1, të këtij neni, ASHK-ja administron edhe aktmarrëveshjen me pronarin e truallit për ndërtimin kryesor, nëse është ndërtuar në territor privat, si dhe aktmarrëveshjen për shtesën, nëse ka të tillë. Në mungesë të aktmarrëveshjes për shtesën, të drejtat dhe detyrimet e palëve për ndërtimin kryesor njësohen me të drejtat dhe detyrimet e palëve në shtesën pa leje.

Neni 21, Legalizimi i ndërtimit

- 1. ASHK-ja, brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit, legalizon ndërtimin, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimet pasurore martesore.
- 2. Poseduesi i ndërtimit pa leje ka të drejtë të kërkojë përfundimin e procedurave administrative, sipas këtij seksioni, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, kundrejt pagesës së një tarife shërbimi shtesë, e cila është e detyrueshme pavarësisht nëse ndërtimi legalizohet ose jo.
- 3. Modeli dhe rregullat për nxjerrjen e aktit të legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- 4. Gjatë procedurave administrative, sipas këtij seksioni, poseduesi i ndërtimit pa leje, me vullnetin e tij, mund të heqë dorë nga e drejta për të përfituar legalizimin, nëpërmjet një

deklarate noteriale. Me administrimin e kësaj deklarate, ASHK-ja përfundon procedurën administrative dhe vendos përjashtimin e ndërtimit nga legalizimi.”

Në pikën 5, të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, parashikohet shprehimisht se:

“5. Legalizimi i ndërtimeve pa leje nga drejtoritë vendore të ASHK-së bazohet në gjendjen faktike të tyre dhe në kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ASHK-së bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi. Institucionet janë të detyruara të shprehen mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre. Në rast moskthimi të përgjigjes brenda këtij afati, ASHK-ja njofton organin epror të institucionit dhe/ose Kryeministrin.

Dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit merren parasysh gjatë procedurës së kualifikimit vetëm për ato elemente, kushte apo kriterë dhe vetëm në ato raste që janë të parashikuara shprehimisht në këtë vendim”.

Në pikën 15, shkronjat gj) dhe h), të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” parashikohet shprehimisht se:

“Ndërtimi pa leje i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtme:.....

gj) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore, ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit;

h) Autoriteti vendor ose institucioni shtetëror kompetent, për zbatimin e një projekti që përbën interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik, ka paraqitur kërkesë të argumentuar për përjashtim nga legalizimi, përpara se ASHK-ja të ketë miratuar legalizimin”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 4, datë 13.07.2021, për sa kohë që ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim që në vitin 2006, preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, në bazë të pikës 15, shkronjat gj) dhe h), të VKM nr. 1040/2020, procesi i legalizimit nuk është vazhduar më tej nga ana e ASHK Tirana Veri.

Nga analizimi i fakteve të sipërcituara rezulton se legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e z. P. L nuk mund të kryhej, pasi ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë,

Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 4, datë 13.07.2021.

Në këto kushte, lind natyrshëm pretendimi i ankuesit, se përse legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e tij nuk është kryer para datës 13.07.2021, pasi vetëdeklarimi i tij është depozituar që me datë 15.09.2006, pranë ish-Aluiznit, Drejtoria Rajonale Tiranë, pra rreth 15 vite më parë se të miratohej plani për ndërtimin e segmentit rrugor *“Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”*.

Referuar parashikimit të nenit 6, pika 1 të ligjit nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”*, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që krijohet me këtë ligj dhe funksionon si institucion me vetëfinancim.

Në nenin 67 të Ligjit të sipërcituar, parashikohet shprehimisht se:

1. *“Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së.*
2. *Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
3. *Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së”.*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht faktit se në vitin 2018, është kryer një riorganizim institucional, duke krijuar institucionin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive të saj rajonale, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të suprimuara janë trashëguar tek institucionet e reja. Janë pikërisht Drejtoritë Rajonale të ASHK-së që shqyrtojnë dosjet e deklarimeve të pashqyrtuara nga ana e Ish-ALUIZN-it.

Ligji nr. 20, datë 05.03.2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”⁸*, ka parashikuar si objekt të tij, përcaktimin e procedurave dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe të inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre.

Në nenin 2, pika 1/c), ka përcaktuar se, qëllimi i këtij ligji është: *“1. Krijimi i bazës ligjore të thjeshtuar e të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private, duke përcaktuar normat për: c) legalizimin dhe regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, ndërtimeve pa leje, objekteve dhe trojeve funksionale, kur mungojnë aktet e fitimit të pronësisë, si dhe të oborreve në përdorim”.*

⁸ Ligji i cili ka shfuqizuar Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar.

Në ligjin nr. 9482/2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”* dhe në VKM nr. 280, datë 01.04.2015 *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”*, të ndryshuar, nuk mund të thuhet se nuk ka afate kohore për përfundimin e procedurave të legalizimit. Kur aplikimi është në përputhje me dokumentacionin e parashikuar në nenin 20, të ligjit nr. 20/2020, (gjë që është përmbushur në rastin konkret), atëherë ASHK-ja verifikon kriteret e kualifikimit për legalizim sipas nenit 18, të ligjit sipërcituar (kriteret që kanë qenë kualifikuese për objektin e ankuesit, deri në daljen e vendimit nr. 4, datë 13.07.2021, të KKT-së). Vlerësimi i kriterëve formale është faza e parë e procedurës, e cila nuk mund të tejzgjatet, për më tepër, mbi 16 vjet, sic dhe ka ndodhur. Kjo procedurë kualifikuese duhej të ishte ezauruar me kohë nga DV ASHK-ja për të kaluar më tej në fazën e dytë, sipas nenit 21, të ligjit 20/2020, ku ASH -ja legalizon ndërtimin brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit.

Gjithsesi, edhe nëse do të ndodheshm në mungesë të parashikimit të afateve, si për çdo organ tjetër administrativ vendimmarrës, zbatohen afatet e parashikuara në nenin 91/2/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohet se:

“2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. 3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.

Nga analizimi i dokumenteve të shqyrtuara dhe legjislacionit të sipërcituar, konstatohet se pas datës 15.09.2006 (kur është bërë Vetëdeklarimi për legalizim të objektit, ndërtim pa leje të ankuesit dhe hapjes së Dosjes së Legalizimit) deri në datë 21.11.2023, kur janë marrë Vendimet nr. 5416, 5417, 5418, 5419, 5420, 5421, 5422, 5423, 5424, 5425, 5426, 5427, për moslegalizimin e objektit 6 katësh të z. P. L, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë dhe më pas Drejtoria Vendore Tirana Veri, nuk kanë kryer asnjë veprim administrativ për legalizimin e objektit të z. L.

Mosrespektimi i kufirit kohor prej dy muajsh për përfundimin e procedurës administrative në rastin objekt shqyrtimi, është i dukshëm, dhe nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri nuk është dhënë asnjë justifikim i arsyeshëm për mosrespektimin e këtij afati procedural për përfundimin e procedurës administrative edhe nëse do të ekzistonte ndonjë situatë e veçantë, e parashikuar nga neni 91/4 të Kodit të Procedurave Administrative.

Procedura e legalizimit të objektit të z. L, nuk është përfunduar nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri, pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht edhe pse ankuesi kishte kryer pagesat e tarifave respektive dhe kishte ndjekur procedurën ligjore me përpikëmeri. Kjo zvarritje shumëvjeçare i ka kushtuar ankuesit heqjen e mundësisë të legalizimit të këtij objekti, pasi në vitin 2021 (me datë 13.07.2021), me miratimin e projektit të rishikuar për ndërtimin e segmentit rrugor *“Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”*, ndërtesa e tij informale preket nga segmenti rrugor i parashikuar në këtë projekt të ri.

Komisioneri konstaton se, për një vepër të tillë të madhe infrastrukturore sic është Unaza e Madhe e Tiranës, studimi i thelluar, detajuar, i planizuar hartografik është bërë me vonesë, i fragmentarizuar dhe jo i plotë si vepër rrugore e kësaj natyre dhe madhësie.

Për vepra të karakterit të tillë studimet, planizimet, koordinimi ndër institucional, duhen bërë me kohë dhe në mënyrë largpamëse që krahas zgjidhjes së problemit të qarkullimit rrugor të minimizohen dëmet ekonomike në pronat e individëve, personave fizikë e juridikë (për efekt shpronësimi) duke mirëadministruar kështu edhe financat publike.

Konstatohet se projekt idea për Unazën e Madhe të kryeqytetit ka qenë para viteve 1990, por me zhvillimet e reja social ekonomike, zbatimi i saj ka filluar në vitin 2009, dhe ku, në vitin 2013 ky projekt është rishikuar.

Nga aktet e paraqitura rezulton se projekti i Unazës së Madhe të Tiranës (të paktën në segmentin Sheshin “Shqiponja-Bulevardi i Ri”, ku ndër të tjera, ndodhej dhe objekti i ankuesit) është fragmentarizuar edhe përsa i përket projektimit të saj (duke ndryshuar apo rishikuar projektin pararendës), duke shkaktuar kështu pasiguri juridike, kosto financiare si për individët ashtu dhe për buxhetin e shtetit.

Për rastin konkret, sipas shkresës me nr. 996/2 prot., datë 09.04.2024, të ARRSH-së, projekti pararendës i Unazës së Madhe, pas ndryshimit të planit rregullues të Bashkisë Tiranë, është rishikuar me Vendimin e KKT-së me nr.4, datë 13.07.2021, për segmentin rrugor “Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri”.

Sigurisht që për elementët e mësipërm të Vendimit të KKT-së, nuk ka detyrim ligjor ASHK-ja, pasi dhe vetë Agjencia është njoftuar në momentet e fundit për miratimin e Vendimit sipërcituar. Për rrjedhojë, është njoftuar edhe ankuesi për moslegalizimin e objektit, për shkak të këtij vendimi – kur pritshmëritë e ligjshme të ankuesit ishin se objekti i tij do të legalizohej, ashtu si pjesës dërrmuese të objekteve të fqinjëve të tij (të cilët kanë përfituar edhe dëmshpërblimet përkatëse).

Parimi i sigurisë juridike, i barazisë para ligjit dhe i ligjshmërisë, si elementë të shtetit të së drejtës kërkon jo vetëm një legjislacion të qartë, por edhe zbatimin efektiv, në afate të arsyeshme, nga organet shtetërore të ngarkuara për zbatimin e tij.

Komisioneri vlerëson se, këto parime juridike nuk janë zbatuar në rastin konkret nga DV ASHK Tirana Veri.

Trajtimi i aplikimit të ankuesit për legalizim pas rreth 16 vitesh (me skualifikim), kur ndërkohë aplikimet e tjera në të njëjtën kohë apo dhe më vonë, janë trajtuar me legalizim të objekteve, ndodhur në të njëjtën zonë kadastrale apo kufitarë e fqinj me ankuesin, kur ky i fundit është treguar aktiv, bashkëpunues në paraqitjen e dokumentacionit, pagesa tarifash, e në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar nga ASHK Tirana Veri, trajtimin e aplikimit të tij, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, barazisë para ligjit, ligjshmërisë, e për rrjedhojë të drejtën e pronës dhe përfitimit të dëmshpërblimit për shkak të shpronësimit për interes publik.

Ankuesi nuk e ka ndërtuar objektin në zona apo vende që, për shkak të përcaktimit ligjor përjashtohen nga procesi i legalizimit, psh në zona arkelologjike, zona të mbrojtura, në vepra publike si: ujësjellës, kolektor, kanale kulluese, etj,

Në rastin konkret, nëse aplikimi i ankuesit për legalizimin e objektit të tij do të shqyrtohej nga ASHK Tirana Veri, *para datës 13.07.2021*, ankuesi do të paisej me lejen e legalizimit të objektit (sikundër janë pajisur objektet kufitare/fqinje), pasi nuk ka ekzistuar shkak ligjor që do të përbënte pengesë për moslegalizimin e objektit të tij, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit 20/2020, i cili parashikon se: *“1.ASHK-ja kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e moscenimit të: a) veprave kryesore të infrastrukturës publike; b) akseve rrugore kombëtare; c) territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike;ç) integritetit të pasurive kulturore materiale, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë; d) territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë; dh) vijës bregdetare, në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit. 2. Ndërtimet pa leje që cenojnë kriteret e mësipërme nuk legalizohen. Ato regjistrohen në bazën e të dhënave vetëm për efekt njohjeje të vlerës së investimit të ndërtimit, sipas parashikimeve në nenin 33 të këtij ligji. 3. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin moslegalizim vetëm për sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi. 4. Procedurat, rregullat dhe dokumentacioni për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Nga përgjigjet shkresore të kthyerë ankuesit, ai është informuar se: “ALUIZI po shqyrton dokumentat tekniko-ligjor (viti 2009), se dosja e tij po trajtohet në hartografi (viti 2009), se po ndiqen procedurat tekniko-ligjore të legalizimit (viti 2014), etj”.

Pengesa ligjore, shkak për moslegalizimin e objektit të ankuesit ka lindur me Vendimin nr. 4, datë 13.07.2021, të KRRT-së.

ASHK Tirana Veri nuk ka kryer në kohë të arsyeshme, efektive, procedurat e kualifikimit për legalizimin e objektit pa leje të ankuesit, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit 20/2020.

Komisioneri vlerëson se, pa shkaqe të arsyeshme, objektive ASHK-ja (ashtu si ish-ALUIZNI) kanë zvarritur shqyrtimin e aplikimit të ankuesit për legalizimin e objektit të tij, gjë që ka pasqyruar cenimin e disa parimeve juridike e të drejtave, të shtjelluara më sipër.

- **Sa i takon pretendimit të ankuesit për trajtim të pabarabartë e të pafavorshëm për legalizimin e objektit të tij informal, krahasuar me aplikuesit e tjerë kufitarë, komshinj të tij.**

Përsa më lart dhe lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri, në raste të ngjashme me atë të ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i kërkoj këtij të fundit, ndër të tjera: *“Informacion lidhur me statusin juridik (të legalizuar, të pa*

legalizuara) të objekteve të banimit që janë në afërsi të banesës (ose kufitarë) së z. P. L dhe që kanë përfunduar procesin e legalizimit”.

Nga aktet e depozituara pranë KMD-së, (Vetëdeklarim për legalizim objekti, nr. zonës 2018 – dosje me nr. 4023) rezulton se, objekti 6 katësh, ndërtim pa leje, është ndërtuar më datë 20.05.2003, dhe se, pozicioni topografik (kufizimet) e tij paraqiten si vijon:

- “Veriu: Xh. C, H. S;
- Jugu: A. K;
- Lindje: F
- Perëndim: P. L”

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ASHK Tirana Veri, nuk vuri në dispozicion praktikën e legalizimit të pasurive, ndërtimeve të shtetasve, të cilët janë kufitarë me pronën e z. L (Xh. C, H. S, A. K....). Dhe as të 10 (dhjetë) shtetasve të tjerë⁹ ndërtimet e të cilëve ndodheshin në të njëjtën zonë kadastrale, dhe në perimetër të përafërt përrreth ndërtimit, objektit 6 katësh të palës ankuese, kërkuar në mënyrë të përsëritur nga KMD-ja, nëpërmjet shkresave me nr. 71 prot., datë 09.01.2025 dhe me nr. 403/2 prot., datë 26.03.2025.

Megjithatë, nga këqyrja e analiza e dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se, nga përmbajtja e shkresave (me nr. 4817/1 prot., datë 14.08.2019 dhe “Kthim përgjigje” e datës 11.02.2022) drejtuar subjektit ankues, nga vetë DV ASHK Tirana Veri, statusi i pasurive për shtetasit e poshtëcituar, rezulton me të dhënat si vijon:

- Pasuria me nr. 10/41, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit S. S, sipas vendimit për legalizim nr. 736, datë 06.04.2021;
- Pasuria me nr. 10/821, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit I. S, sipas lejes së legalizimit me nr. 88193, datë 20.08.2014;
- Pasuria me nr. 10/366, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit Xh. C, sipas lejes së legalizimit me nr. 4765, datë 01.02.2011;
- Pasuria me nr. 10/767-ND, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit A. K, sipas lejes së legalizimit me nr. 1230399, datë 21.09.2018;
- Pasuria me nr. 10/77, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit A. I, sipas lejes së legalizimit me nr. 1233195, datë 31.08.2020;

⁹ Informacion dhe kopje të dokumentacionit (respektivisht kopje e kërkesës për aplikim dhe të vendimit për legalizim të objektit, për secilin subjekt), si më poshtë citohen:

- Për pasurinë me nr. 10/41, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit S. S;
- Për pasurinë me nr. 10/821, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit I. S;
- Për pasurinë me nr. 10/366, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit Xh. C;
- Për pasurinë me nr. 10/767-ND, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit A. K;
- Për pasurinë me nr. 10/77, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit A. I;
- Për pasurinë me nr. 10/284, në zonën kadastrale 8310, në pronësi të subjektit K. T;
- Për pasurinë me nr. 10/72, në zonën kadastrale 8310;
- Për pasurinë me nr. 10/366, në zonën kadastrale 8310
- Për pasurinë me nr. 10/854, në zonën kadastrale 8310;

- Pasuria me nr. 10/284, në zonën kadastrale 8310, rezulton e afishuar në pronësi të subjektit K. T, sipas lejes së legalizimit me nr. 903801, datë 25.04.2016.

Sa më lart, evidentohet vetëm data e miratimit të lejes së legalizimit për secilin subjekt, por jo datat e vetëdeklarimeve të bëra prej tyre, në formularin e vetëdeklarimit për legalizim objekti.

Nga pala ankuese është pretenduar se, nga ana e DVASHK Tirana Veri janë dhënë lejet e legalizimit edhe për pasuritë me:

- Nr. 10/72, në zonën kadastrale 8310;
- Nr. 10/366, në zonën kadastrale 8310
- Nr. 10/854, në zonën kadastrale 8310;
- Nr. 10/772, në zonën kadastrale 8310, për të cilat DV ASHK Tirana Veri nuk iu përgjigj kërkesës së KMD-së për të sjellë dokumentacion për këto pasuri.

Në një analizë krahasuese të procedurave të legalizimit mes subjektit ankues, z. P. L dhe të paktën 6 (gjashtë) shtetasve, kufitarë me objektin e tij, ndërtim pa leje, të ndjekura nga ASHK Tirana Veri, rezulton se, lejet e legalizimit për pasuritë e tyre, datojnë respektivisht, më:

- datë 01.02.2011;
- datë 20.08.2014;
- datë 25.04.2016;
- datë 21.09.2018;
- datë 31.08.2020;
- dhe me datë 06.04.2021.

Pra, nga analizimi i procedurave të sipërcituara, rezulton se:

Për këto subjekte, kufitarë më pasurinë, objektin e z. L, nga DV ASHK Tirana Veri, janë dhënë lejet e legalizimit të ndërtimeve të tyre pa leje, gjatë periudhës kohore 2011-2021, pavarësisht se sipas deklarimeve të ankuesit, kishin aplikuar për legalizimin në të njëjtën periudhë kohore, vitet 2005-2006. (Z. P. L ka kryer procesin e vetëdeklarimit në datë 15.09.2006)

Vlen të evidentohet dhe theksohet se, DV ASHK-ja, ka legalizuar dy objekte, respektivisht: 11 (njëmbëdhjetë) muaj (më datë 31.08.2020), dhe 3 muaj e gjysëm (më datë 06.04.2021) përpara se të dilte vendimi nr. 4, datë 13.07.2021, i KKT-së, ku këto objekte, banesa prekeshin nga projekti i Unazës. Por, në ndryshim nga ankuesi, për këto dy objekte (kufitare me objektin e tij), pronarët e tyre janë shpronësuar dhe kanë marrë dëmshpërblimet përkatëse.

Në këtë mënyrë evidentohet qartazi trajtimi i pabarabartë dhe i pafavorshëm i ankuesit me këto subjekte, që kishin ndërtime informale, të cilët ishin në kushte të njëjta më ankuesin, pasi pronat e tyre janë kufitarë në të njëjtën zonë ku do zhvillohej projekti, ndërtimi i segmentit rrugor “*Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë*”.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit dhe mbylljen e procedurave të legalizimit për objektin e z. P. L është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar.

Në referencë të parashikimeve ligjore që parashikojnë afatet e procedurave administrative të legalizimit, është më se e qartë se ligji ngarkon institucionin e ASHK Tirana Veri me barrën e provës për të vërtetuar mosrespektimin e këtij afati.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ASHK Tirana Veri, nuk arriti të provojë arsyet e vonës në shqyrtimin e dokumenteve të legalizimit të objektit të z. L, dhe as të trajtimit të tij në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme, krahasimisht me personat sipërcituar në vendim, ndodhur në të njëjtën zonë banimi (zonë kadastrale), tek e cila janë prishur të gjitha ndërtimet, me ndryshimin se atyre u janë legalizuar paraprkisht, ndërsa ankuesit jo.

Për sa më sipër, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHK Tirana Veri, lidhur me mostrajtimin në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës së tij për legalizim objekti informal.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2¹⁰, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

B. 1 Çdo shkak tjetër (përkatësia në grupin shoqëror të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë të regjimit komunist)

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë

¹⁰“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

të një shkaku të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Në radhë të parë, shkaku i pretenduar si diskriminues nga pala ankuese, duhet të parashikohet nga ligji, dhe *në radhë të dytë*, pala ankuese duhet të provojë se e posedon shkaku të pretenduar.

Në ankesën objekt shqyrtimi, subjekti ankues pretendon se është diskriminuar për shkak të *përkatësisë në një grup të veçantë shoqëror*, si familje dhe personalisht, të persekutuar politikë, me statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë - bazuar në Vërtetimin për dhënie statusi, me nr. 622 prot., datë 04.07.2024, të Institutit të Integritetit të Ish-të Përndjekurve Politikë.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹¹. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh¹².

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

¹¹ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

¹² Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹³ Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.¹⁴ Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”¹⁵.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e liritimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), është “*veçoria personale*” në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GJEDNJ, shkaku i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ, dhe nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara¹⁶.

Ankuesi shpjegon se, është diskriminuar për shkak se atij nuk i është legalizuar ndërtesa, objekt informal, pikërisht për shkak se ai vjen nga shtresa e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist. në ndryshim nga personat e tjerë të ndodhur në të njëjta kushte me të (posedues të ndërtimeve informale) të cilëve iu janë leglizuar objektet informale.

¹³ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

¹⁴ Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹⁵ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

¹⁶ Handbook on European Non-discrimination Laë. EU FRA and CoE, 2010.97

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Bazuar në aktet e administruara rezulton e provuar se, ankuesi e posedon shkakun e përkatësisë në këtë grup të veçantë shoqëror, atë të ish-përndjekurve politikë pasi e ka dokumentuar atë. Ai ka pretenduar se nuk i është legalizuar objekti informal pikërisht për këtë shkak.

Shpjegimi dhe dokumentimi i shkaqeve të pretenduara të diskriminimit me bazë, shkak gjendjen shoqërore, në rastin specifik si të përndjekur politikë të regjimit komunist, lidhet me interpretimin që jep Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në kuadër të Neni 14, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokolleve përkatëse, duke specifikuar se: *"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë lloj diskriminimi mbi çfarëdo baze, si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, përkatësia me një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose një status tjetër."*

Shpjegimi i "statusit tjetër" përfshin edhe gjendjen, faktin si ish-i përndjekur politik, pra dikush që ka vuajtur represion nga regjimi komunist për bindje politike, shoqërore ose fetare.

Referuar çështjes "Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë" (2004), GJEDNJ (në rastin e dy qytetarëve që ishin përjashtuar nga ushtrimi i disa profesioneve për shkak të lidhjes së tyre të mëparshme me KGB-në sovjetike), vendosi që masa e ndalimit ishte disproporcionale dhe diskriminuese në raport me qëllimin e mbrojtjes së interesit publik. Ky rast vendosi dhe një parim të rëndësishëm, që statusi i dikujt në të kaluarën (qoftë edhe në rrethana politike apo shoqërore) nuk mund të jetë shkak për ndalim ose trajtim të pabarabartë, nëse nuk ka një justifikim të fortë dhe proporcional.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkak të qenies së tij pjesë e kategorisë shoqërore të personave ish-të përndjekur politikë të regjimit komunist, duke pretenduar se është trajtuar në mënyrë të diferencuar, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në procedurën e ndjekur nga DV ASHK Tirana Veri, lidhur me legalizimin e ndërtimit të tij informal.

E drejta për të përfituar statusin e ish-të persekutuuarit/dënuarit politik, u garantua me ligjin nr. 7748/1993 *"Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist"*.

Rasti i ankuesit gëzon provueshmëri të këtij shkakut, bazuar në Vërtetimin për dhënie statusi, me nr. 622 prot., datë 04.07.2024, të Institutit të Integritetit të Ish-të Përbjekurve Politikë, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

Bazuar në analizën sa më sipër, Komisioneri, vlerëson të provuar nga ankuesi, shkakun e pretenduar të diskriminimit, (pjesë e kategorisë shoqërore të personave ish-të përndjekur politikë të regjimit komunist) si shkak që gëzon mbrojtje ligjore, duke referuar tek “çdo shkak tjetër”, tek lista e shkaqeve të LMD-së.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga DV ASHK Tirana Veri, me shkakun e mbrojtur nga LMD, “çdo shkak tjetër” (pjesë e kategorisë shoqërore të personave ish-të dënuar dhe të përndjekur politikë të regjimit komunist).

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë ndodhur në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me të drejtat ligjore të tij.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e pronësisë bazuar në standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 17, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.*

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 18, i Kushtetutës ku sanksionohet ky parim parashikon : *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”.*

Në nenin 59, pika 1, shkronja b), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet shprehimisht detyrimi i shtetit shqiptar për plotësimin e nevojave të shtetasve të tij, për strehim. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet se: *“1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹⁷.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

¹⁷ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Në përputhje me Nenin 11(1) të Komentit të Përgjithshëm Nr.4: E drejta për strehim të mjaftueshëm e Komitetin Evropian për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore (KEDS), strehimi i përshtatshëm duhet të plotësojë një sërë kriteresh, dhe në veçanti duhet të përfshijë gjithashtu mbrojtjen efektive nga organet përgjegjëse kombëtare.

Lidhur me të drejtat themelore, shtetasit shqiptarë përballet me situata të vështira për sa i përket zbatimit të të drejtave lidhur me pronën, çështje kjo e ngritur dhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2020, në të cilin, në faqen 29 dhe 35 shkruhet se: “Në vitin e ardhshëm, Shqipëria: - duhet të konsolidojë ngulitjen e të drejtave pronësore, veçanërisht përmes përfundimit të regjistrimit të parë, avancimit për regjistrimin e akteve të pronës, zbatimin e skemës së kompensimit dhe vazhdimin e progresit të duhur lidhur me digjitalizimin dhe hartëzimin e pronës. Fq. 35. Në lidhje me të drejtat e pronës, është i nevojshëm progresi i vazhdueshëm drejt përparimit të procesit të regjistrimit, digjitalizimit dhe kompensimit. Shqipëria, si çështje përparësie, duhet të përfundojë regjistrimin e parë të pronave të patundshme dhe të titujve të pronësisë në territorin e saj”.

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata, në qëndrimet e saj ka qenë jashtëzakonisht e rreptë në lidhje me diskriminimin për shkak të racës ose përkatësisë në grupe të vecanta shoqërore, duke u shprehur se: “Asnjë diferencë në trajtim, që bazohet ekskluzivisht ose në një masë vendimtare tek përkatësia etnike apo shoqërore e një personi nuk mund të përliqet objektivisht në një shoqëri demokratike bashkëkohore, të ndërtuar në parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme”. Detyrimi ligjor i organeve shtetërore dhe e drejta për të përfituar nga parashikimet e mësipërme ligjore, për kategorinë e individëve që i përkasin minoriteteve dhe grupimeve shoqërore të caktuara, të cilët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sociale, ekonomike, juridike, etj, sanksionohet dhe në aktet ligjore e nënligjore kombëtare, në të njëjtën frymë si në aktet ndërkombëtare sipërcituar.”

Në nenin 10, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, gjen parashikim edhe parimi i mosdiskriminimit. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.”

E drejta për të përfituar statusin e ish-të persekutuarit/dënuarit politik, u garantua me ligjin nr. 7748/1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”,

duke përcaktuar saktë në të kriteret për të përfituar këtë status dhe të drejta të tjera lidhur me të.

Neni 12¹⁸ i ligjit 7748/1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, parashikon se:

“....Të gjithë atyre personave që përfshihen në nenin 3, pikat a, b, c dhe d, Qeveria me anë të akteve të veçanta të saj do t’iu garantojë krijimin e lehtësirave dhe të përparësive të kërkesave të tyre individuale apo kolektive në fushat e mëposhtme të veprimtarisë ekonomike, financiare dhe sociale: a) Në fushën e privatizimit të pronës shtetërore;

b) Në fushën e dhënies së kredive;

c) Në fushën e ndërtimeve dhe strehimit;

d) Në fushën e turizmit;

e) Në fushën e arsimit dhe të kualifikimit;

f) Në fushën e punësimit brenda dhe jashtë vendit;

g) Në fushën e realizimit të programeve të ndryshme ekonomike dhe sociale kombëtare dhe ndërkombëtare;

h) Në fushën e shërbimit shëndetësor.

Afati i përfundimit të këtyre përparësive vendoset me ligj të veçantë”.

Në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, Qeveria Shqiptare ka miratuar disa dokumenta, siç janë Plani Kombëtar i Integritetit Europian dhe Udhërrëfyesi për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, “*masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë kategori të vecanta shoqërore dhe politikat antidiskriminuese*”.

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotype negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si *një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër*

¹⁸ Të drejta të tjera

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS19 gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme

dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹⁹”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ shprehet se: “... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.²⁰”.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga (viktima e diskriminimit) te (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se trajtimi nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese...”

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet

¹⁹ GjEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²⁰ GjEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GjEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminim.²¹

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*”²².

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues:

Së pari, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e DV ASHK Tirana Veri.

²¹https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

²² GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pabarabartë dhe i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e DV ASHK-së, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara, KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga DV ASHK Tirana Veri, kundrejt subjektit ankues, që i përket kategorisë shoqërore të ish persekutuarve dhe ish të përndjekurve politik të sistemit komunist, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesi është diskriminuar për shkak se ai i përket kategorisë shoqërore të ish persekutuarve dhe të përndjekurve politikë të sistemit komunist, pasi rezultoi e provuar se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme lidhur me procedurën e ndjekur për legalizimin e objektit të tij informal, dhe se ky trajtim është bërë në mënyrë të pajustikuar objektivisht dhe ligjërisht.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës²³, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e DV ASHK Tirana Veri, si në raport me të drejtën e tij ligjore, lidhur me kërkesën së për legalizim objekti informal, ashtu dhe në të drejtën për tu trajtuar me barazi para ligjit.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, nga ana e DV ASHK-së.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që ankuesi e mbart shkakun e pretenduar, argumentuar në pjesën B.1, të Vendimit.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e DV ASHK-së, për faktin se u ishte bërë i ditur shkresërisht, si nga ankuesi personalisht, ashtu edhe nëpërmjet komunikimit shkresor të instancave të tjera si IPP, Prefekti, etj, por edhe për faktin se nga ana e KMD-së i është bërë e ditur që ankuesi ka pretenduar diskriminim pikërisht për shkak të përkatësisë së tij shoqërore në kategorinë e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politik nga sistemi komunist.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e DV ASHK Tirana Veri, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e DV ASHK-së, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që për veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta dhe të arsyeshme, si dhe që ai të ishte trajtuar në mënyrë të barabartë me aplikuesit e tjerë (analizuar në pjesën e II-të të Vendimit) kufitarë me të.

²³ Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të vendimit të KMD.

Adresa: Rruga "Durrësit", Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, DV ASHK Tirana Veri, pavarësisht njohjes të faktit se:

- personave që gëzojnë statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, (sipas përcaktimeve të ligjit 7748/1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”) duhet t’u garantohet krijimi i lehtësirave dhe i përparësive të kërkesave të tyre individuale apo kolektive, përfshirë dhe fushën e ndërtimeve dhe strehimit,
- ankuesi gëzon statusin e ish-të dënuarit dhe përndjekurit politik nga sistemi komunist, sërish nga ana e DV ASHK Tirana Veri nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të trajtuar kërkesën e ankuesit për legalizim të objektit të tij informal, në kohë, me drejtësi e barazi nga ana e tyre, por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “pala e akuzuar”, DV ASHK-ja, nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshme, lidhur me kërkesën e tij për legalizim objekti.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, DV ASHK-ja :

- nuk ka shqyrtuar brenda një afati të arsyeshëm ligjor aplikimin e ankuesit për legalizim;
- nuk ka provuar dhe argumentuar shkaqet objektive apo subjektive të vonësës 16 vjecare në shqyrtimin e aplikimit të ankuesit, kur ndërkohë aplikime të tjera të paraqitura në të njëjtën kohë apo më vonë nga ai, janë shqyrtuar me përfundim legalizimin e tyre;
- nuk ka provuar se ka trajtuar ankuesin në mënyrë të barabartë (përsa i përket aspektit kohor) me kufitarët e tjerë, komshinj, në procedurën e legalizimit të objektit të tij.

Referuar dokumentit të publikuar në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH)²⁴: “Raport përfundimtar i auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë”, Komisioneri, evidenton se, në përmbajtjen e tij, ndër të tjera, theksohet se:

“Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1171/I, datë 16.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.01.2023 deri në datën 20.04.2023, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë u krye në teren auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, zbatimi i rekomandimeve, mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, si dhe të disa Drejtorive kryesore të ASHK...”

²⁴ Raporti-perfundimtar-per-auditimin-e-ushtruar-ne-Drejtorine-e-Pergjithshme-te-Agjencise-Shteterore-te-Kadastres

Në pikën 2, të këtij dokumenti: “Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve”, ndër të tjera, pasqyrohen gjetjet si më poshtë, duke i cituar si të rëndësishme të lartë:

Përmbledhje e gjetjes

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), u konstatua se për vitin 2021 kjo strukturë ka konstatuar se 30% e ankimeve lidhen me faktin se nga Drejtoritë Vendore të ASHK-ve, legalizohen objekte të specifikuara dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë. Ky fenomen për vitin 2022 është konstatuar në masën 18% të ankimeve. Nga shqyrtimi i ankesave të marra gjatë vitit 2021, nga DAB në 369 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankimues, ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e Drejtorive Vendore të ASHK-ve nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo situatë për vitin 2022 është reflektuar në 274 raste. Për vitin 2021 dhe 2022, respektivisht në 56 dhe 366 ankime administrative, nuk është arritur të nxirret një konkluzion i qartë nga DAB, pasi Drejtoritë Vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë, apo nuk kanë përcjellë fare informacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra funksionale e Drejtorive Vendore të ASHK.

Rekomandimi:

Me qëllim monitorimin e shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së Drejtorive Vendore të ASHK-ve, trajtimin si duhet prej tyre të çështjeve të pronësisë së qytetarëve, për të gjitha rastet që Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, gjatë trajtimit të ankimeve administrative të bëra nga qytetarët, konstaton shkelje të bëra nga Drejtoritë Vendore, të përcjellë këto shkelje pranë Drejtorit të Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm të analizojë të gjitha rastet me qëllim ndërprerjen e praktikave të gabuara të cilat nuk respektojnë kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të marrë masa për personat përgjegjës.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, si dhe është tërësisht i papërligjur në fakte, prova e dispozita ligjore.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se DV ASHK Tirana Veri, e ka trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshme, subjektin ankues, z. P. L, krahasimisht me kufitarët e tij sipërcituar në vendim, për shkak të përkatësisë shoqërore, si ish i dënuar dhe i përndjekur politik nga sistemi komunist, duke sjellë për

pasojë diskriminimin e tij, përsa i takon mostrajtimit në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës për legalizimin e objektit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimeve diskriminuese nga ana e DV ASHK Tirana Veri.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, z. P. L, për për shkak të përkatësisë së tij shoqërore, si ish i të dënuar e i përndjekur politik nga sistemi komunist, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e DV ASHK Tirana Veri, lidhur me mostrajtimin në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës së tij për legalizim objekti informal.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA